



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Burimeve Njerëzore



Rr. " Sami Frashëri", nr.8, Tiranë. Tel: +3554223815.E-mail: info@fsdksh.com.al. Web://wwwfsdksh.com.al

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

1 (një) Specialist Jurist në Sektorin e Kontrollit Financiar Spitalor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor Tiranë të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Arsimin e Lartë, Fakulteti Juridik;
- Të jetë i komunikueshëm dhe të ketë aftësi të punës në grup;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh (preferohet anglisht);
- Nota mesatare do të jetë avantazh;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Fondit, **brenda datës 18 Prill 2017**, si më poshtë;

- Kërkesë për punësim.
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale (curriculum vitae).
- Diplomë e noterizuar.
- Diplomë Master e noterizuar.
- Listë notash e noterizuar.
- Çertifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme.
- Çertifikatë kompjuteri
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar.
- Librezën e punës.
- Fotokopje e kartës së indentitetit.

- Dëshmi penalteti (të datojë brenda 3 muajve të fundit).
- Çertifikatë Familiare.
- Raport mjekësor për aftësi në punë.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet.

Adresa:

Drejtoria e Sherbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Rruga e Dibrës QSUT. Tel. 042 – 375529, E-mail:dshsuks@fsdksh.com.al